



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRAN

01 Nr. / Br 147/16

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data / Datum 28. 07. 2016

VUSHTRIKU - VUČITRAN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 pika “d”, të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, neni 41.2 pika “ç” Statutit të Komunës, neni 8.2 të rregullores 01Nr.37-2/11, dt. 24.02.2011 për përcaktimin e kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndhimë Momentale Entiteteve Publike dhe Jopublike, si dhe në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës për aprovimin e buxhetit nr. 186/15, i datës 29.09.2015, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë, në mbledhjen e mbajtur me **28 korrik 2016** mori këtë:

VENDIM

PËR NDARJE TË MJETEVE FINANCIARE NGA BUXHETI I KOMUNËS – FONDI PËR TRANSFERE DHE SUBVENCIONE


1. Me këtë vendim ndahen mjete financiare në shumën prej 4.000 (katërmijë euro) nga buxheti i komunës – fondi për transfere dhe subvencione të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, pjesëmarrje në financim të ndërtimit të shtëpisë për banim për:

- 1.1. Z. Lutfi Hajdari, nga fshati Mihaliq, në shumën prej 2.000 € (dymijë euro);
- 1.2. Z. Naser Bilalli, nga fshati Pasomë, në shumën prej 2.000 € (dymijë euro).

2. Mjetet e ndara me këtë vendim shfrytëzohen si bashkëfinancim me donator, të cilët kanë siguruar shumë prej 26.000 € (njëzet e gjashtë mijë euro) për ndërtimin e dy shtëpive të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendim.


3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit.



Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit




Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **28 korrik 2016**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2017 duke u bazuar në nenin 12.1 pika "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

1. Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2017.
2. Diskutimi publik fillon nga data 01 gusht 2016 dhe zgjatë deri më 31 gusht 2016.
3. Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
4. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa (DBF), dhe Komisioni për Hartimin e Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2017 që si hartues dhe propozues i aktit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013. Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin shtator 2016.
5. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLICA E KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCITRN	
01 Nr. / Br	149/16
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data / Datum	28. 07. 2016
VUSHTRRI - VUCITRN	



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2016, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2017 duke u bazuar në nenin 12.1 pika "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:


V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

1. Jepet në diskutim publik Draft-Buxheti i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017.
3. Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
4. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa (DBF), që si hartues i Draft-Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Buxhetit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin shtator 2016.
5. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Duke u Bazuar në Nenin 12.2 pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetë qeverisje Lokale, nenin 41.2 pika “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2016 mori këtë:

VENDIM

PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË KOMUNËS PËR NËNSHKRIMIN E “MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MES KOMUNËS SË VUSHTRRISË DHE SPITALIT SHEYKH ZAYDE ”

- 1.Me këtë vendim autorizohet kryetari i komunës, për nënshkrimin e “Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe Spitalit Sheykh Zayde ”.
- 2.Qëllimi i kësaj marrëveshje mes Komunës së Vushtrrisë dhe Spitalit “Sheykh Zayde” është funksionalizimi i shërbimit urgjent dhe emergjent pranë Spitalit “Sheykh Zayde” në bashkëpunim me Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH).
- 3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
- 4.Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Shpëtim Zhegrova
Kryesuesi i Kuvendit



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 pika "d" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5, 7 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144, neneve 30 dhe 31 të Ligjit për Tokën Bujqësore Nr.02/L-26 ,nenit 4 të Rregullores QRK NR.23/2013 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 80 pika "h" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **28 korrik 2016** mori këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM ME KOMPENSIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS –TOKËS BUJQËSORE DHE KULLOSAT

1.Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim me kompensim e pronës së paluajtshme të komunës-tokës bujqësore dhe kullosat në këto ngastra kadastrale :

1.1 Ngastra Kadastrale me nr.P-177/1 dhe P-227 me sipërfaqe prej 08.85.97 ha, Zona Kadastrale Dobërlluk, pronë e komunës së Vushtrrisë;

1.2 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202028-00087-0, me sipërfaqe prej 02.07.50ha, Zona Kadastrale Stanofc i Poshtëm, pronë e komunës së Vushtrrisë;

1.3 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202022-00142-0, me sipërfaqe prej 01.02.35ha,Zona Kadastrale Stanofc i Poshtëm ,pronë e komunës së Vushtrrisë;

1.4 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202022-00754-0, me sipërfaqe prej 01.37.69 ha, Zona Kadastrale Gracë ,pronë e komunës së Vushtrrisë;

1.5 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202022-00756-0, me sipërfaqe prej 00.72.05 ha, Zona Kadastrale Gracë ,pronë e komunës së Vushtrrisë;

1.6 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202028-00067-0, me sipërfaqe prej 02.03.85 ha, Zona Kadastrale Stanovc i Poshtëm ,pronë e komunës së Vushtrrisë;

1.7 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202017-00565, me sipërfaqe prej 7.30.00 ha, Zona Kadastrale Gllavotin ,pronë e komunës së Vushtrrisë;


1.8 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202042-00004-0, me sipërfaqe prej 13.84.83 ha, Zona Kadastrale Miraçë ,pronë e komunës së Vushtrrisë.

2. Ngastrat kadastrale të cekura në piken 1 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim afatshkurtër me veprimtari kryesisht për kultura lavërtarë, çmimi fillestar do të jetë 50 € euro për 1 ha në vit, në afat për 10 vite.

3. Obligohet Komisioni për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale të zhvilloj procedurat për shpalljen e ankandit si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë :certifikata për të drejtën e pronësisë dhe kopja e planit.

5. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUCITRN

01 Nr. / Br 152/16

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 28. 07. 2016

VUSHTRRI - VUCITRN




Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në mbështetje të nenit 13.1 pika "a" të Ligjit mbi Tokën Bujqësore Nr.02/L-26, nenit 17 pika "b" dhe "f" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 41.2 pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2016, mori këtë:


VENDIM
MBI LEJIMIN E NDËRRIMIT TË DESTINIMIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME
NË PRONËSI TË KOMUNËS

- 1.Me këtë vendimi lejohet ndërrimi i destinimit për parcelën P-70202016-02119-0, në sipërfaqe prej 499 m², ZK-Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë nga shfrytëzimi aktual "lum" e njëjta destinohet në rrugë publike.
2. Për Zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në mbështetje të nenit 12.2 pika "d" dhe 40.2"ç" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41.2 "ç" të Statutit të komunës, Vendimit të KK-së 01Nr. 186/15 i datës 29.09.2015 për aprovimin e buxhetit të komunës për vitin 2016, si dhe duke u bazuar në kërkesën e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve Dega-Vushtrri të parashtruar me datën 26.07.2016, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **28 korrik 2016** mori këtë:

**VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR SHOQATËN E FAMILJEVE TË
DËSHMORËVE**

- 1.Me këtë vendim Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve i ndahen mjete financiare në vlerë prej dy mijë e pesëqind euro (2.500 €), për zhvillimin e aktiviteteve të sajë.
- 2.Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendim ndahen nga kategoria transfere dhe subvencione fondi 22 dhe do të shërbejnë për organizimin e aktiviteteve për nderë të 1 shtatorit Ditës së Dëshmorëve të UÇK-së.
3. Për Zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.




Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 pika "d", të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 6, 7 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144, nenit 11,12 të Rregullores QRK NR.23/2013 për Caktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 41.2 pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë „Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me **28 korrik 2016**, mori këtë :

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PËR 99 VITE TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE NDËRTIMORE TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË

- 1.Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite e pronës së paluajtshme të komunës së Vushtrrisë në ngastrat kadastrale nr. 2256-11-e cila është pronë e komunës, Zona Kadastrale Vushtrri, me kulture oborr 500 m²,kullosë 110m² dhe ndërtesë 200m² gjegjësisht gjithsejtë: 810m² ku nga sipërfaqja e përgjithshme jepen në shfrytëzim 675 m², e cila gjendet në rrugën "Jeton Tërrstena" Vushtrri.
- 2.Prona e cekura në pikën 1 të këtij vendimi jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite përmes konkursit publik, për perona fizik dhe juridik, për rregullimin dhe ndërtimin e objektit banesor-afarist të cilat janë të parapara sipas Planeve Rregulluese Urbane në fuqi.
- 3.Komuna do ta ruaj interesin e saj publik përmes kushteve që do ti përcaktoj me rastin e zhvillimit të procedurave të konkursit publik, kurse pjesën tjetër investitori.
- 4.Obligohet Komisioni për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale të zhvilloj procedurat për shpalljen e ankandit si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit.
- 5.Pjesë e këtij Vendimi janë: certifikatat e pronësisë kopja e planit incizimi gjeodezik, skica e Planit Zhvillimor Komunal të Vushtrrisë e paraqitur në pjesë grafike dhe pjesa tekstuale.
6. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi shfuqizohet vendimi i kuvendit të komunës me 01 nr.127/16 i datës 30.06.2016, për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale ndërtimore të Komunës së Vushtrrisë.
7. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit